




TAKSA MË TË LARTA NË DUHAN PËR SHËNDET MË TË MIRË DHE GJENERIM MË TË MADH TË TË HYRAVE

Konsumi i duhanit shkakton tetë milionë vdekje në botë çdo vit¹ dhe shpenzimi në produkte të duhanit ridestimon burimet e ekonomive familjare nga nevojat tjera siç janë arsimit dhe shëndetësia². Kosova i ka miratuar disa ligje për të kontrolluar dhe reduktuar konsumimin e duhanit përfshirë Ligji për Akcizën në Produktet e Duhanit³, Ligji për Prodhimin, Grumbullimin, Përpunimin dhe Tregtimin e Duhanit⁴, dhe tash së fundmi Ligji për Kontrollin e Duhanit⁵. I fundit është në përputhje me Nenin 5 të Konventës Kornizë për Kontroll të Duhanit të Organizatës Botërore të Shëndetësisë⁶ e cila sugjeron strategji të shumfishta për kontroll të konsumit të duhanit.

Prevalenca e konsumit të duhanit në Kosovë është shumë e lartë.

Të dhënat për prevalencën e konsumit të duhanit në Kosovë janë të ndryshme varësisht nga burimi. Përderisa të dhënat e Agjencisë së Statistikave të Kosovës paraqesin një prevalencë të konsumit të duhanit prej 16 për qind për 2015-2017,⁷ të dhënat nga një anketë e STEPS të vitit 2011 tregojnë për një prevalencë prej 19.7 për qind për njerëzit e moshës 15-64 vjeçare, dhe 28.4 për popullatën e përgjithshme⁸. Sidoqoftë, Anketa e Buxhetit të Ekonomive Familjare nga viti 2007-2017 tregojnë që në mesatare, më shumë se 40 për qind e ekonomive familjare konsumojnë cigare (Grafikoni 1).



Grafikoni 1: Përhapja e pirjes së duhanit ndër vite tek ekonomitë familjare

Burimi: Përlloraritjet e autorëve nga të dhënat e ABEF (Agjencia e Statistikave të Kosovës) 2007-2017

¹ Organizata Botërore e Shëndetësisë. (2019, korrik 26). Duhanit. Marrë me 8 nëntor 2019 nga <http://bit.ly/2JYPs1W>

² Chaloupka FJ dhe Blecher E. Tobacco & Poverty: Përdorimi i duhanit i varfëron më shumë të varfrit; rritja e taksave mund ta ndryshojë këtë. Analizë e politikave për ekonominë e duhanit. Chicago, IL: Ekonomia e duhanit, Instituti për Studimin e Politikave Shëndetësore, Universiteti i Illinois në Chicago. www.tobaccconomics.org

³ Gazeta Zyrtare, Ligji nr. 04/L-021 për akcizën në produkte të duhanit. Marrë me 21 nëntor 2019 nga <http://bit.ly/33dCioN>

⁴ Gazeta Zyrtare, Ligji nr. Për Prodhimin, mbledhjen, përpunimin dhe tregtimin e duhanit. Marrë me 21 nëntor 2019 nga <http://bit.ly/339QPSi>

⁵ Gazeta Zyrtare, Ligji nr. 04/L-156 për kontrollimin e duhanit. Marrë me 21 nëntor 2019 nga <http://bit.ly/33emnqq>

⁶ Konventa e OBSH për kontrollimin e duhanit <http://bit.ly/Worldhofc>

⁷ Agjencia Kosovare e Statistikave: Rezultatet nga Anketimi i buxhetit të ekonomive shtëpiake, 2017, f. 12, në: <https://bit.ly/2V9OTGa>

⁸ Gashi. Sanije, dhe të tjerët: Sjelljet e pirjes së duhanit në Kosovë: Rezultatet e anketës së Steps, 2016 në: <https://bit.ly/2VbLEOC>

Çmimet më të larta zvogëlojnë konsumimin e duhanit në Kosovë.

Sipas rezultateve në këtë hulumtim, prevalenca e konsumit të duhanit, apo vendimi për të pirë apo mos të pirë duhan, nuk duket që në Kosovë ndikohet nga çmimi. Sidoqoftë, intensiteti i konsumit të duhanit, apo numri i cigareve të konsumuara nga duhanpirësi, ka një ndërlidhje me ndryshimet e çmimit. Një rritje prej 10 për qind në çmim, do të rezultonte në 3.9 për qind, mesatarisht, konsumim më të vogël të cigareve. Në të njëjtën kohë, një ngritje e të hyrave prej 10 për qind, mesatarisht të do rriste konsumimin e duhanit për 7.8 për qind, pasi që 2.1 për qind

e njerëzve që aktualisht nuk pijnë duhan do të fillonin të pinin, dhe ata që pijnë do të rrisnin konsumimin e cigareve për 5.7 për qind. While the average price of cigarettes has been increasing, it is still very low.

Edhe pse çmimi mesatar i cigareve ka shënuar ngritje, prapë mbetet shumë i ulët.

Në vitin 2007 çmimi mesatar për një pako të cigareve ka qenë 1.04 euro, ndërsa në vitin 2017 është ngritur vetëm deri në 1.52 euro për pako. Me çmime kaq të ulëta nuk është e çuditshme prevalenca e konsumit të duhanit nuk ka rënë gjatë kësaj periudhe.




Figura 2. Çmimi mesatar i cigareve^{1,2}

¹ Ulja e çmimeve sipas IÇK vlerave të vitit 2007; përfaqësimi sipas vlerave të njësisë (proporcioni i shpenzimeve për cigare të ekonomive shtëpiake me sasinë e cigareve konsumuara)

Burimi: Kalkulimi sipas autorëve të të dhënave të ABEF (Agjencia Kosovare e Statistikave) 2007-2017

Ekonomitë familjare me të hyra të ulëta dhe të mesme janë shumë të ndjeshme ndaj ndryshimeve në çmime, prandaj edhe mund të përfitojnë shumë nga çmimet e larta.

Ekonomitë familjare me të hyra të ulëta dhe të mesme do të reduktonin konsumimin e cigares me 5.3 për qind, respektivisht 6.3 për qind, nëse çmimet

do të rriteshin për 10 për qind, përderisa ekonomitë familjare me të hyra të larta nuk duket që reagojnë ndaj ndryshimit të çmimit. Në të njëjtën kohë, 10 për qind rritje në të hyra do të rriste konsumimin në të gjitha grupet: me të hyra të vogla, të mesme dhe të larta me 6.7, 8.9, dhe 6.2 për qind, respektivisht (Tabela 1).

Figura 1: Elasticiteti e çmimeve dhe të të ardhurave sipas grupeve të të ardhurave

	Ekonomitë familjare me të hyra të ulëta		Ekonomitë familjare me të hyra të mesme		Ekonomitë familjare me të hyra të larta	
Elasticiteti i prevalencës						
Çmimi	-0.658	(0.909)	0.004	(1.074)	0.467	(1.233)
Të hyrat	0.097	(0.088)	0.266***	(0.318)	0.213***	(0.074)
Elasticiteti i intensitetit						
Çmimi	-0.532**	(0.217)	-0.630**	(0.254)	-0.294	(0.486)
Të hyrat	0.668***	(0.090)	0.626***	(0.123)	0.405***	(0.056)

Burimi: Përlllogaritjet e autorëve nga të dhënat e ABEF

Çmimet e larta në cigare do të zvogëlonin konsumin dhe do të gjeneronin të hyra shtesë për qeverinë.

Figura 2 tregon për një rritje të çmimit prej 25 për qind, përmes rritjes së tarifave në akcizë prej rreth 48 për qind apo nga rreth 43 euro (sipas vitit bazë 2017) në 63.6 euro, që do të ulte pirjen e duhanit për rreth 11.1 për qind. Ekonomitë familjare me

të ardhura të ulëta dhe të mesme do të përfitonin më së shumti nga ngritja e çmimeve me një ulje të konsumit me 16.3 në 18.4 përqind, respektivisht. Në të njëjtën kohë qeveria do të mblidhte rreth 25 për qind të hyra shtesë apo rreth 42 milion euro.

Figura 2: Ndikimi i projektuar nga rritja e çmimit për 25 për qind në konsumim dhe të hyra të qeverisë

Grupi sipas të ardhurave	Konsumimi (pako)			Të hyra (EUR)		
	Baza ¹	Skenari ¹	Ndryshimi	Baza ²	Skenari ²	Ndryshimi
Të ulëta	46.0	38.5	-16.3%	€ 53.2	€ 63.2	18.9%
Të mesme	47.2	38.5	-18.4%	€ 54.6	€ 63.2	15.9%
Të larta	45.5	46.4	1.7%	€ 52.7	€ 76.1	44.4%
TOTAL	138.8	123.5	-11.1%	€ 160.5	€ 202.6	26.2%

¹ për milion pako; ² në miliona euro

Burimi: Përlogaritjet e autorëve nga të dhënat e ABEF

Figura 2 tregon që rritja e çmimit për 25 për qind, do të ulë konsumimin e duhanit për 11.1 për qind. Kjo figurë po ashtu tregon ndikimin e rritjes së çmimit në konsumimin e duhanit sipas grupeve të ndryshme të të ardhurave. Rezultati jep indikacione që grupet me të ardhura të mesme do të përfitonin më së shumti nga rritja e çmimeve pasi që në këtë grup të ekonomive familjare konsumimi do të ulej për 18.4 për qind. Konsumimi i cigareve për ekonomitë familjare me të hyra të vogla do të zvogëlohej për 16.3 përqind, përderisa te ekonomitë familjare me të ardhura të larta, ndikimi do të ishte i ndryshëm, ngase ato do të rrisnin konsumin e cigares për 1.7 për qind.

Ky simulim po ashtu merr në konsideratë edhe rritjen e të hyrave të qeverisë, duke sugjeruar që një rritje e çmimit prej 25.0 për qind po ashtu do të rriste edhe të hyrat e qeverisë për 26.2 për qind apo për 42 milionë euro. Të hyrat më të mëdha do të ishin nga mbledhja e taksave nga grupi me të hyra të larta (44.4 për qind), që lë të kuptohet që ky ndryshim i politikave do të rriste progresin në sistemin e tatimeve.

Në përgjithësi, ky simulim ilustron efikasitetin dhe progresin e ngritjes së çmimit për 25 për qind

edhe në aspekt të përgjithshëm por edhe brenda tri grupeve të ndryshme të të ardhurave. Simulimi tregon se të hyrat e qeverisë do të rriteshin ndërsa konsumimi i cigares në grupet me atë ardhura të ulëta dhe të mesme do të ulej.

Përfundime dhe rekomandimet për politika

Rritja e akcizës dhe çmimeve në duhan mbetet politika më efektive në uljen e kërkesës për duhan. Shkalla e akcizës specifike në vitin 2019 prej 47 euro për njësi konvencionale është sa gjysma e kërkesës minimale për akcizën në duhan sipas direktivës së Bashkimit Evropian e cila është 90 euro për njësi.⁹ Deri më tani, iniciativat dhe politikat legjislative në Kosovë nuk kanë pasur rezultat në uljen e kërkesës për duhan. Rezultatet tregojnë që rritja e çmimit për pako të cigareve ka ndikim të drejtpërdrejtë në uljen e kërkesës për konsumim të duhanit, e për rrjedhojë edhe rritjen e të hyrave të qeverisë. Prandaj, Qeveria e Kosovës duhet të kontribuojë në përmirësimin e shëndetit dhe të mirëqenies së qytetarëve të saj përmes rritjes së akcizës specifike në duhan për vitin 2020 nga 47 euro në 69.7 euro për 1000 cigare, si dhe në të njëjtën kohë, të gjenerojë buxhet shtesë që është mese i nevojshëm.

⁹ European Union Commission, at: <https://bit.ly/2FOrDrY>

Autorë:

Besnik Prekazi M.A dhe Erëza Pula MSc

Rreth projektit:

Demokrasi Plus është duke punuar në bashkëpunim me Institutin për Shkenca Ekonomike në Beograd, i cili është duke e koordinuar një rrjet regjional hulumtuesish në Evropën Juglindore për hulumtime rreth taksave në duhan. Projektit financohet nga Universiteti i Illinois Chicago (UIC) Instituti për Hulumtime dhe Politika Shëndetësore. UIC është partner i Iniciativës së Bloomberg për Uljen e Përdorimit të Duhanit. Qëndrimet e shprehura në këtë dokument nuk mund t'i atribuohen e as nuk paraqesin qëndrimet e UIC, Institutit për Hulumtime dhe Politika Shëndetësore apo Bloomberg Philanthropies.